



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 48 Prot

Tiranë, më 01.06 2012

VENDIM Nr. 13 dt. 31.05.2012

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 31.05.2012, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI

Lidhur me diskutimi i kërkesave të qytetarëve:

1. **Miratohet me shumicë votash:** Projekti i riformulimit të ndërtesës tre katëshe me bodrum rruga "Kardinal Mikel Koliqi", Shkodër me pronar Mark Beka. (3 Kate)
 2. **Miratohet:** Projekt restaurimi i objektit hotel "Argjiro", Gjirokastër. (Çatia të mbulohet me rrasë guri).
 3. **Miratohet:** Projekt restaurimi i objektit 3 kate + bodrum me porositës Françesk Gjeloşi, Shkodër.
 4. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa e Andon Zamos, lagja Palorto, Gjirokastër.
 5. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni dhe përshtatje fragment nga kompleksi pranë portës së pashait, në pronësi të z. Evdal Durra, lagja Mangalem, Berat.
 6. **Miratohet:** Projekt Rikonstruksion banese 2-3 kate; Pronari Vellazeria "Cyreku", Lagjja Nr. 11 Rr. "Llazi Pendavinji", Korçë. (Të zbatohet varianti me dy dritare).
 7. **Miratohet:** Projekt Restaurimi i baneses 1 ½ kate, me pronar Sean Edëard Mason, Zona e mbrojtur (ish depo e ujit), Korçë.
 8. **Miratohet:** Projekt Restaurimi i baneses 2-3 kate me ambiente shërbimi+ podrum, me pronar Kastriot Labollari dhe Myfis Gjonmadhi, Rruga "Don Ndre Mjeda", Korçë, (Projekti të supervizohet nga ASHA)
 9. **Miratohet:** Projekt Restaurim i ambienteve ndihmese 1-2 kate, me pronar Gavril dhe Petri Jatru (Eqimi), Bulevard "Republika" Lagjja Nr. 1, Korçë.
- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
 - Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

SEKRETAR I KKR

AKADEMIK. APOLLON BAÇE

Rruga "Aleksandër Mojsiu", nr. 76, Tiranë (AL), Email: ink@albemail.com